



Republika e Kosovës – Republika Kosovo  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 896/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e paraqitur nga Eliesa Reshiti, kandidate për Kuvendin Komunal në Rahovec nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** i bazuar Apeli Anr.896/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Eliesa Reshiti, kandidate për Kuvendin Komunal në Rahovec nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Rahovec të subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Rahovec, për Vendvotimet: 1622A/02R, 1608A/01R, 1608A/04R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në këto vendvotime, të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.856/2021 nga Eliesa Reshiti, kandidate për Kuvendin Komunal në Rahovec nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën kërkon që të rinumërohen vendvotimet 1622A/02R, 1608A/01R, 1608A/04R pasi që e njëjta dyshon se votat e familjareve të saj të cilët e kane votuar i mungojnë dhe të njëjta dyshon se u janë bartur kandidatëve tjerë. Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe emrat dhe dokumentet e disa personave për të cilët pretendon se kane votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

#### **Apeli është i bazuar**

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të votave të kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Eliesa Reshiti, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Rahovec siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuese andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Rahovec për Vendvotimet: 1622A/02R, 1608A/01R, 1608A/04R dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.896/21 më datë 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit  
Ferki Xhaferi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.